

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaCeram®-243 UltraFlex

KOLLË PLLAKASH ME BAZË ÇIMENTOJE DHE PERFORMANCË TË LARTË, KATEGORIA C2TES1 SIPAS EN 12004-1



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaCeram®-243 UltraFlex është kollë pllakash me performancë të lartë, ambalazh të gatshëm, ngjyrë të bardhë, e deformueshme, që nuk rrëshqet, me kohë të zgjatur punueshmërie, me përmbajtje të lartë polimeresh, agregatesh të përzgjedhura dhe aditivësh të posaçëm.

SikaCeram®-243 UltraFlex mund të përdoret për ngjitje pllakash në shtresë me trashësi deri në 15mm, për aplikime në mjedise të brendshme dhe të jashtme, mbi sipërfaqe vertikale dhe horizontale.

PËRDORIMET

SikaCeram®-243 UltraFlex është i përshtatshëm për ngjitje të:

- Pllakave qeramike monocottura, bicottura
 - Pllakave me përmasa të mëdha
 - Mozaikut
 - Pllakave clinker, cotto
 - Pllakave prej graniti artificial (përfshihen pllakat grès porcelanato)
 - Mermerit dhe gurit natyror (pa ndjeshmëri ndaj ujit)
- SikaCeram®-243 UltraFlex mund të përdoret mbi nënshtresa të ndryshme si:
- Betoni dhe llaçi
 - Produkte fleksibël me bazë çimentoje (p.sh. Sikalastic®-1K)
 - Shtresa ekzistuese mermeri, pllaka qeramike dhe mozaik
 - Tulla dhe suva
 - Pllaka gipsi, çimentoje, etj. (me prajmer të përshtatshëm)

SikaCeram®-243 UltraFlex mund të përdoret mbi dysheme dhe mure në mjedise të brendshme e të jashtme, mbi sipërfaqe horizontale dhe vertikale ku përfshihen:

- Kuzhinat, banjat, ballkonet, verandat
- Pishinat, rezervuarët
- Banja, dushe
- Sipërfaqet me ngrohje nën dysheme
- Sipërfaqet me qarkullim të shpeshtë
- Fasadat

SikaCeram®-243 UltraFlex është i përshtatshëm për përdorim me ngrohje nëndysheme, mbi fasada, pishina dhe mjedise të jashtme, si pjesë e **Sistemit Sika të kollave të pllakave** në kombinim me llaçet fleksibël dhe hidroizolues me bazë çimentoje Sikalastic® (sipas EN 14891).

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Pjesë e **Sistemit Sika të kollave të pllakave** në kombinim me llaçet fleksibël dhe me bazë çimentoje Sikalastic®
- Tepër i deformueshëm
- Kohë e zgjatur punueshmërie
- Tiksotropi e lartë, pa rrëshqitje vertikale
- Ndërkapje e shkëlqyer edhe mbi nënshtresat kërkuese
- Aplikim dhe shtrim i lehtë
- Rezistencë ndaj motit dhe ujit
- I aplikueshëm deri në 15 mm

MIRATIME / STANDARDE

Markë CE dhe Deklaratë Performance sipas EN 12004-1 - Kolla për pllakat qeramike

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	çimento Portland, agregate të përzgjedhura, aditivë të posaçëm dhe polimere
Ambalazhi	thes 25 kg

Paraqitja / Ngjyra	Pluhur, i bardhë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur, në kushte të thata dhe temperatura midis +5°C dhe +35°C.
Dendësia	Dendësia e llaçit të freskët: ~ 1.60 kg/l (në +20°C)
Përmasa maksimale e kokrrizës	~ 0,5 mm

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	≥ 1,0 N/mm ² (fillestare) ≥ 1,0 N/mm ² (pas vjetërimit në nxehtësi) ≥ 1,0 N/mm ² (pas zhytjes në ujë) ≥ 1,0 N/mm ² (pas ciklit ngrirje shkrire)	(EN 12004-2)
Shformimi tërthor	≥ 2,5 mm	(EN 12004-2)
Rezistenca ndaj rrëshqitjes	≤ 0,5 mm	(EN 12004-2)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes	6,5 – 7,3 L ujë për thes 25 kg		
Konsumimi	Konsumimi varet nga profili i sipërfaqes dhe ashpërsia e nënshtresës, ashtu si dhe nga përmasa e pllakave dhe metoda e vendosjes së tyre (aplikim i kryqëzuar ose aplikim mbi nënshtresë por edhe në pjesën e pasme të pllakës).		
	Përmasa e pllakës	Madhësia e mallës	Konsumimi
	Pllaka të vogla dhe mozaik	6 mm	~ 2 – 3 kg/m ²
	Pllaka normale (20x20cm – 45x45cm)	8 mm	~ 3 – 4 kg/m ²
	Pllaka mesatare dhe të mëdha (p.sh. 60x120cm)	10 mm	~ 4 – 5 kg/m ²
	Pllaka shumë të mëdha / nënshtresë shumë e ashpër / teknikë përhapjeje të ngjitësit në pjesën e pasme të pllakës dhe nënshtresës	12 – 15 mm	~ 5 – 7 kg/m ²
Trashësia e shtresës	max. 15 mm		
Temperatura e mjedisit	+8°C min. / +35°C max.		
Temperatura e nënshtresës	+8°C min. / +35°C max.		
Koha e punueshmërisë	~ 3-4 orë në +23°C		
Koha e përpunimit	≥ 30 minuta (rezistenca e ndërkapjes në tërheqje ≥ 0,5 N/mm ²) (EN 12004-2)		
Koha e përshtatjeve	~ 30 min. në +23°C		
Produkti i aplikuar gati për përdorim	Përpara mbushjes së fugave të pllakave të dyshemeve - qarkullim i lehtë	24* orë	
	Përpara mbushjes së fugave të pllakave të të mureve	5-12* orë	
	Qarkullim i plotë	~14* ditë (21* ditë në rezervuare & pishina)	
	*Vlera të përfuturuar në kushte laborator: 23°C ± 2°C – lagëshi relative 50% ± 5%. Temperaturat e larta reduktojnë kohët e treguara, ndërsa temperaturat e ulëta i zgjasin.		

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Në kushte normale nuk nevojitet prajmer kur produkti aplikohet mbi nënshtresa çimentoje, suva, beton, pllaka ekzistuese, mozaik, mermer. Në rast nënshtresash shumë absorbuese ose të vështira, mund të përdoren prajmerat e mëposhtëm:

Nënshtresa	Prajmer
Nënshtresa poroze (pllaka gipsi, çimentoje etj.)	Sika® Primer-11 W
Dysheme PVC-je, linoleum, veshje epokside, suvatime gipsi, etj.	Sika® Primer-21 W
Izolim poresh / përmirësues i ngjitjes mbi nënshtresa joporoze (p.sh. pllaka të vjetra)	SikaTop®-10
Nënshtresa metalike	SikaFloor®-156/161 (spërkatje me rëre kuarci)

Për nënshtresa të tjera, ju lutemi këshillohuni me departamentin teknik. Për informacione të mëtejshme referohuni tek skeda teknike përkatëse me të dhënat e produkteve në fjalë.

Nënshtresa nuk duhet të ketë kore çimentoje, duhet të jetë e pastër dhe pa pislleqe, vaj, graso apo kontaminues të tjerë dhe grimca të lira.

Nënshtresa duhet të jetë plotësisht e sheshtë, e qëndrueshme dhe me moshën e duhur. Çdo pjerrësi e vogël apo gungë, mund të nivelohet dhe të mbushet me një shtresë SikaCeram®-243 UltraFlex në trashësi max. 5 mm, të aplikuar të paktën 24 orë përpara shtrimit të pllakave. Për trashësi më të mëdha, mund të përdoren llaçet e përgatitur me SikaLatex® Max ose Sika ViscoBond®, apo llaçet për riparime Sika® MonoTop® ose SikaRep®.

Në rast kërkesash për nivelim të nënshtresës, mund të përdoren llaçet e vetënivelueshëm nga seria Sika® Level.

PËRZIERJA

Përzieri thesin 25 kg me sasinë e përshtatshme të ujit që përmendet më sipër, duke përdorur mikser elektrik me spirale të përshtatshme në shpejtësi të ulët, në një enë të pastër deri sa të përftohet një pastë homogjene pa kokrriza. Pas përzierjes, lini produktin të qëndrojë për 5min. dhe përzieri sërish përpara aplikimit. Përzierja e përftuar duhet të jetë shumë kremoze, lehtësisht e përhapshme dhe shumë tiksotropike.

APLIKIMI

SikaCeram®-243 UltraFlex aplikohet me mallë të dhembëzuar. Sasia e produktit duhet të jetë e mjaftueshme që të sigurohet mbulimi plotë i pjesës së pasme të pllakës. Shtrimi i pllakave duhet të bëhet mbi sipërfaqen e kollës së freskët, duke ushtruar presionin e duhur që të sigurohet kontakti i plotë i kollës me pllakën dhe kështu të arrihet një ngjitje e shkëlqyer. Në rast se mbi sipërfaqen e kollës është krijuar një cipë, duhet që të kaloni sërish mallën tek sipërfaqja e saj përpara shtrimit të pllakave. Shmangni lagjen e shtresës së kollës së aplikuar, pasi kjo gjë mund të dëmtojë procesin e ngjitjes. Zgjidhni përmasën e duhur të mallës sipas madhësisë së pllakës.

SikaCeram®-243 UltraFlex mund të përdoret për fiksimin e pllakave me absorbueshmëri të ulët me përmasë maksimale:

Përmasat e pllakës	Përdorimi
Deri në 12.000 cm ² (p.sh.100cm x 120cm)	Nënshtresa dyshemeje të brendshme
Deri në 3.600 cm ² (p.sh. 60cm x 60cm)	Nënshtresa dyshemeje të jashtme
Deri në 2.100 cm ² (p.sh. 30cm x 60cm)	Nënshtresa muri të jashtme dhe të brendshme

Për shtrime pllakash me sipërfaqe totale 900 cm² (p.sh. 30x30 cm) dhe më të mëdha, rekomandohet gjithnjë teknika e aplikimit të kollës edhe në pjesën e pasme të pllakës.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga mjetet dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i fortësuar/ tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Nënshtresat me bazë gipsi duhet të kenë trashësi min. 10 mm dhe lagështi maksimale të përmbajtur 0,5%.
- Nëse nevojitet hidroizolim shtesë nën pllaka, mund të përdoren produktet e mëposhtme: SikaTop® Seal 107 FL-X, Sikalastic®-152, Sikalastic®-1K, Sika® SealTape-S.
- Për aplikime me kërkesa të veçanta (p.sh. sipërfaqe të jashtme ose pishina), përdorni poshtë kollës së pllakës një produkt sipas EN 14891 (p.sh. Sikalastic®-1K, kategoria CMO1P)
- Mos tejkaloni dozën max. të rekomanduar të ujit. Aplikoni vetëm mbi sipërfaqe të qëndrueshme dhe të përgatitura në mënyrën e duhur. Mos tejkaloni trashësinë e rekomanduar të shtresës (trashësia max. shtresë është 15mm).
- Mbroni materialin e freskët të aplikuar nga ngrirja, shiu etj. për të paktën 24 orë.
- Nuk nevojitet lagia e pllakave përpara ngjitjes së tyre.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova

laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositetë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
SikaCeram®-243 UltraFlex
Gusht 2019, Botimi 03.01
020404020010000348

SikaCeram-243UltraFlex-sq-AL-(08-2019)-3-1.pdf

